



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Javna Razsvetljava d.d Branch in Kosovo” të datës 24.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** si e **bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Javna Razsvetljava d.d Branch in Kosovo” të datës 24.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “Javna Razsvetljava d.d Branch in Kosovo” (tutje si “parashtruesi”) me datë 24.06.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me numër të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë formuluar si në vijim:

**Pretendimi nr. 1** – Arsyeya për eliminimin tonë nga ky AP është tërësisht e pasaktë. Në ofertën tonë është dorëzuar katalogu origjinal në përputhje të plotë me specifikat teknike për trupa ndriçues ku ndër të tjera përfshihet edhe pozicioni 1, 2 dhe 3. Në këtë mënyrë ne kemi përmbushur tërësisht këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Mirëpo përtej kërkesës së DT, ne përveç katalogut kemi dorëzuar edhe autorizimin e prodhuesit për distribuim, autorizimin për prodhim si dhe letrën për garancionin e distribuimit. Pra nga cilido këndvështrim i mundshëm ne kemi stërpërmbushur këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Rrjedhimisht elimini mi ynë nga aktiviteti i prokurimit mbi bazën e këtij arsyetimi është tërësisht i pasaktë, i padrejtë por padyshim edhe i kundërligjshëm. Sidoqoftë, së bashku me këtë kërkesë për rishqyrtim po ju bashkangjesim edhe një herë katalogun dhe dokumentet përcjellëse sikurse i kemi dorëzuar edhe në ofertën tonë me rastin e tenderimit.

**Pretendimi nr. 2** – operatori ekonomik “Besa Company” Sh.P.K i rekomanduar për LOTIN 2 ka dorëzuar ofertë të papërgjegjme prandaj nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës por duhet të eliminohet si tenderues i papërgjegjshëm nga ky AP.

**Pika 1** – “Besa Company” Sh.P.K. ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët. Çmimi me të cilin ka ofertuar ky OE është dukshëm më i ulët sesa 30% nën mesataren e çmimit mesatar me të cilin kanë ofertuar tenderuesit OE në këtë AP si dukshëm më shumë sesa 10% nën çmimin e dytë më të lirë pas tij. Konkretisht mesatarja e çmimeve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit është 663.18 euro ndërsa çmimi me të cilin ka ofertuar “Besa Company” është 132.01 euro apo rreth 80.1% më i ulët. Njëkohësisht çmimi i dytë më i ulët është 239.74 euro që nënkupton se çmimi i ofertuar nga “Besa Company” është 44.93% më i ulët sesa çmimi i dytë më i lirë pas tij (pra dukshëm nën 10%). Konsiderojmë se nuk ka nevojë për asnjë ekspertizë profesionale apo shkencore për të kuptuar që nëse AK nënshkruan kontratë me këtë OE, atëherë kontrata si e tillë do të dështoj pasi që OE do t’a ketë të pamundur që të përmbushë detyrimet e saj kontraktuese me këtë çmim jonormalisht të ulët. Sidoqoftë, për hirë të korrektësisë duhet cituar edhe nenin 41.3 të RRPP ku përcaktohet se një çmim mund të trajtohet si jonormalisht i ulët në rastet kur “është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë”. Nga sa u tha më sipër është elaboruar mjaftueshëm se tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët prandaj duhet të eliminohet si i papërgjegjshëm nga ky aktivitet i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë.

**Pika 2** – “Besa Company” Sh.P.K. nuk ka përmbushur kërkesën e parë lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në DT. OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur këtë kërkesë pasi që nuk ka plotësuar aneksin 6 të DT me listën e kontratave ku saktësohet titulli, shuma, datat e fillimit dhe përfundimit si dhe përfituesi. Në vend të kësaj OE ka dorëzuar një listë të cilën e ka përpiluar vetë mirëpo e cila nuk përkon me formën e tabelës sipas aneksit 6 dhe mbi të gjitha aty mungojnë datat e saktë të përfundimit. Po ashtu shumë prej kontratave që janë përmendur në këtë listë nuk janë fare kontrata të ngjashme me natyrën e kontratës, pastaj referencat që janë bashkangjitur

nuk përputhen me kontratat e përmendura në listë, etj. Pra nga secili këndvështrim i mundshëm OE nuk ka arritur që të përmbushë as këtë kërkesë të DT.

**Pika 3** - "Besa Company" Sh.P.K. nuk ka përmbushur kërkesën e shtatë lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në DT. OE sa i përket menaxherit të projektit nuk ka dorëzuar fare kontratë të punës ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt por ka dorëzuar vetëm një draft kontratë për punë dhe detyra specifike. Kjo draft-kontratë është lidhur për një projekt që qenka publikuar nga Komuna e Ferizajt dhe nuk ka asnjë ndërlidhje me këtë projekt të AK Komunës së Prishtinës. Përndryshe OE për menaxherin e projektit ka dorëzuar vetëm një projekt për disa projekte të cilat nuk ndërlidhen me sistemin SMART të ndiçimit publik. Në CV nuk potencohet projektet e natyrës së ngjashme, etj. Prandaj OE nuk e ka përmbushur as këtë kërkesë të DT.

**Pika 4** - "Besa Company" Sh.P.K. nuk ka përmbushur kërkesën 7.3 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në DT. OE nuk ka dorëzuar CV dhe diplomat/çertifikatat për stafin teknik. Po ashtu ka dorëzuar disa kontrata të punës dhe disa çertifikata për siguri dhe shëndet në punës mirëpo të cilat nuk përkrijnë mes tyre. Prandaj nuk është përmbushur as kjo kërkesë e DT.

**Pika 5** - "Besa Company" Sh.P.K. nuk ka përmbushur kërkesën e DT lidhur me pasjjet dhe makineritë e kërkuara. Kjo sepse nuk ka plotësuar/nënshkruar/vulosur fare aneksin 7 të bashkangjitur me formularin e dosjes së tenderit (plotësimi i formularit të DT është kusht administrativ). Rrjedhimisht nuk ka dorëzuar dëshimtë e nevojshme dokumentare për të konfirmuar se i posedon të gjitha pajisjet e kërkuara nga AK.

**Pretendimi nr. 3** - operatori ekonomik "Risamont" Sh.P.K i rekomanduar për LOTIN 4 ka dorëzuar ofertë të papërgjegjme prandaj nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës por duhet të eliminohet si tenderues i papërgjegjshëm nga ky AP.

**Pika 1** - "Risamont" Sh.P.K. ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët. Çmimi me të cilin ka ofertuar ky OE është dukshëm më i ulët sesa 30% nën mesataren e çmimit mesatar me të cilin kanë ofertuar tenderuesit OE në këtë AP si dukshëm më shumë sesa 10% nën çmimin e dytë më të lirë pas tij. Konkretisht mesatarja e çmimeve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit është 658.6 euro ndërsa çmimi me të cilin ka ofertuar "Risamont" është 132.9 euro apo rreth 79.82% më i ulët. Njëkohësisht çmimi i dytë më i ulët është 247.61 euro që nënkupton se çmimi i ofertuar nga "Risamont" është 46.33% më i ulët sesa çmimi i dytë më i lirë pas tij (pra dukshëm nën 10%). Pra nëse AK nënshkruan kontratë me këtë OE, atëherë kontrata si e tillë do të dështoj pasi që OE do t'a ketë të pamundur që të përmbushë detyrimet e saj kontraktuese me këtë çmim jonormalisht të ulët. Duhet cituar edhe nenin 41.3 të RRPP ku përcaktohet se një çmim mund të trajtohet si jonormalisht i ulët në rastet kur "është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë". Nga sa u tha më sipër tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët prandaj duhet të eliminohet si i papërgjegjshëm nga ky aktivitet i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë.

**Pika 2** - "Risamont" Sh.P.K. nuk ka përmbushur kërkesën e shtatë lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në DT. OE sa i përket menaxherit të projektit nuk ka dorëzuar

dokumentet e nevojshme me të cilat dëshmohet se i njëjti posedon së paku 5 vite përvojë të punës profesionale pas diplomimit sikurse është kërkuar me DT.

**Pika 3** - "Risamont" Sh.P.K. nuk ka përmbushur kërkesën 7.3 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në DT. Mungojnë pesë punonjës teknik me SSHP, CV, Kontratë dhe diploma. Vetëm për 3 punonjës janë dorëzuar dokumentet e kompletuara. Prandaj nuk është përmbushur as kjo kërkesë e DT.

**Pika 4** - "Risamont" Sh.P.K. nuk ka përmbushur kërkesën e DT lidhur me pasijet dhe makineritë e kërkuara. Kjo sepse nuk kamioni me kran nuk është i regjistruar me librezë ndërsa kamioni me kiber nuk ka regjistrim.

**Pretendimi nr. 4** - operatori ekonomik N.Sh. "M.V.R.Elektromontues" i cili ka tenderuar për lot 2, 3 dhe 4, ka dorëzuar ofertë të papërgjegjme prandaj nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës por duhet të eliminohet si tenderues i papërgjegjshëm nga ky AP. Konkretisht këtij operatori ekonomik i mungojnë dëshmitë e përfundimit të projekteve me referenca sipas listës së kontratave që ka prezantuar në ofertën e tij. Ngjashëm mungojnë edhe diplomat për disa nga punonjësit teknik. Përndryshe edhe ky OE ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët pasi që edhe çmimi i këtij OE është dukshëm më i ulët sesa çmimi mesatar i tenderuesve të tjerë si dhe më i ulët sesa 10% i çmimit të dytë më të ulët pas tij. Rrjedhimisht as ky OE nuk ka përmbushur kërkesat si më sipër të DT dhe për këtë arsye duhet të eliminohet nga AP si ofertues i papërgjegjshëm.

**Pretendimi nr. 5** - operatori ekonomik "Anesi" Sh.P.K. i cili ka tenderuar për lot 2, 3 dhe 4, ka dorëzuar ofertë të papërgjegjme prandaj nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës por duhet të eliminohet si tenderues i papërgjegjshëm nga ky AP. Kjo për arsye se ky OE nuk ka përmbushur kërkesat mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas DT. Konkretisht nuk ka dorëzuar fare deklaratat tatimore në ATK për tri vitet e fundit. Në vend të kësaj OE ka dorëzuar një vërtetim nga banka NLB ku thuhet se nga data 01.01.2021 deri me datë 03.04.2024 ka qarkullim prej 902,668.83 euro. Mirëpo kërkesa e DT ka qenë specifike dhe aty thuhet se kërkohet qarkullimi në tri vitet e fundit që nënkupton vetëm për vitin fiskal 2021, 2022 dhe 2023 por jo edhe për vitin 2024 sepse ky vit fiskal ende nuk ka përfunduar.

**Pretendimi nr. 6** - grupi i operatorëve ekonomik "Elektrostublla Sh.P.K. & Item El Sh.P.K." i cili ka tenderuar për lot 2, 3 dhe 4, ka dorëzuar ofertë të papërgjegjme prandaj nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës por duhet të eliminohet si tenderues i papërgjegjshëm nga ky AP. Kjo për arsye se sipas referencave të bashkangjitur ky GOE, janë dëshmuar vetëm 798,000.00 euro vlerë të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë. Rrjedhimisht nuk është plotësuar kërkesa e DT.

**Lidhur me pretendimin ankimor nr. 1** - në ofertën e parashtruesit është gjetur se është dorëzuar edhe katalogu origjinal në përputhje të plotë me specifikat teknike për trupa ndriçues ku ndër të tjera përfshihet edhe pozicioni 1, 2 dhe 3. Po ashtu është dorëzuar edhe autorizimi i prodhuesit për distribuim, autorizimi për prodhim si dhe letra për

garancionin e distribuimit. Rrjedhimisht eliminimi nga aktiviteti i prokurimit mbi bazën e këtij arsyetimi është tërësisht i pasaktë, ndërsa pretendimi ankimor është i bazuar.

**Lidhur me pretendimin ankimor nr. 2** – është gjetur se tenderuesi i rekomanduar për lot 2 “Besa Company” Sh.P.K. ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët. Çmimi me të cilin ka ofertuar ky OE është dukshëm më i ulët sesa 30% nën mesataren e çmimit mesatar me të cilin kanë ofertuar tenderuesit OE në këtë AP si dukshëm më shumë sesa 10% nën çmimin e dytë më të lirë pas tij. Konkretisht mesatarja e çmimeve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit është 663.18 euro ndërsa çmimi me të cilin ka ofertuar “Besa Company” është 132.01 euro apo rreth 80.1% më i ulët. Njëkohësisht çmimi i dytë më i ulët është 239.74 euro që nënkupton se çmimi i ofertuar nga “Besa Company” është 44.93% më i ulët sesa çmimi i dytë më i lirë pas tij (pra dukshëm nën 10%). Rrjedhimisht komisioni vlerësues ka shkelur nenin 41 të RRPP ndërsa pretendimi ankimor është i bazuar. Njëkohësisht është gjetur se ky tenderues i rekomanduar nuk ka plotësuar aneksin 6 të DT me listën e kontratave ku saktësohet titulli, shuma, datat e fillimit dhe përfundimit si dhe përfituesi. Në vend të kësaj OE ka dorëzuar një listë të cilën e ka përpiluar vetë mirëpo e cila nuk përkon me formën e tabelës sipas aneksit 6 dhe mbi të gjitha aty mungojnë datat e saktë të përfundimit. Tutje OE sa i përket menaxherit të projektit nuk ka dorëzuar fare kontratë të punës ose marrëveshje për angazhim në këtë projekt por ka dorëzuar vetëm një draft kontratë për punë dhe detyra specifike. Kjo draft-kontratë është lidhur për një projekt që qenka publikuar nga Komuna e Ferizajt dhe nuk ka asnjë ndërlidhje me këtë projekt të AK Komunës së Prishtinës. Përndryshe OE për menaxherin e projektit ka dorëzuar vetëm një projekt për disa projekte të cilat nuk ndërlidhen me sistemin SMART të ndiçimit publik. Në CV nuk potencohet projektet e natyrës së ngjashme, etj. Prandaj OE nuk e ka përmbushur as këtë kërkesë të DT. Tutje ky OE nuk ka dorëzuar CV dhe diplomat/çertifikatat për stafin teknik. Po ashtu ka dorëzuar disa kontrata të punës dhe disa çertifikata për siguri dhe shëndet në punës mirëpo të cilat nuk përkojnë mes tyre. Prandaj nuk është përmbushur as kjo kërkesë e DT. Po ashtu ky OE nuk ka plotësuar/nënshkruar/vulosur as aneksin 7 të bashkangjitur me formularin e dosjes së tenderit (plotësimi i formularit të DT është kusht administrativ). Kësisoj është gjetur se ky pretendim ankimor është i bazuar.

**Lidhur me pretendimin ankimor nr. 3** – është gjetur se operatori ekonomik “Risamont” Sh.P.K i rekomanduar për LOTIN 4 ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët. Çmimi me të cilin ka ofertuar ky OE është dukshëm më i ulët sesa 30% nën mesataren e çmimit mesatar me të cilin kanë ofertuar tenderuesit OE në këtë AP si dukshëm më shumë sesa 10% nën çmimin e dytë më të lirë pas tij. Konkretisht mesatarja e çmimeve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit është 658.6 euro ndërsa çmimi me të cilin ka ofertuar “Risamont” është 132.9 euro apo rreth 79.82% më i ulët. Njëkohësisht çmimi i dytë më i ulët është 247.61 euro që nënkupton se çmimi i ofertuar nga “Risamont” është 46.33% më i ulët sesa çmimi i dytë më i lirë pas tij (pra dukshëm nën 10%). Rrjedhimisht komisioni vlerësues ka shkelur nenin 41 të RRPP ndërsa pretendimi ankimor është i bazuar. Tutje ky OE nuk ka përmbushur kërkesën 7.3 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional në DT. Mungojnë pesë punonjës teknik me SSHP, CV, Kontratë dhe diploma. Vetëm për 3

punonjës janë dorëzuar dokumentet e kompletuara. Prandaj nuk është përmbushur as kjo kërkesë e DT. Ngjashëm nuk ka përmbushur kërkesën e DT lidhur me pasijet dhe makineritë e kërkuara. Kjo sepse nuk kamioni me kran nuk është i regjistruar me librezë ndërsa kamioni me kiber nuk ka regjistrim. Kësisoj është gjetur se ky pretendim ankimor është i bazuar.

**Lidhur me pretendimin ankimor nr. 4** - është gjetur se operatori ekonomik N.Sh. "M.V.R.Elektromontues" i cili ka tenderuar për lot 2, 3 dhe 4, i mungojnë dëshmitë e përfundimit të projekteve me referenca sipas listës së kontratave që ka prezantuar në ofertën e tij. Ngjashëm mungojnë edhe diplomat për disa nga punonjësit teknik. Përndryshe edhe ky OE ka ofertuar me çmim jonormalisht të ulët pasi që edhe çmimi i këtij OE është dukshëm më i ulët sesa çmimi mesatar i tenderuesve të tjerë si dhe më i ulët sesa 10% i çmimit të dytë më të ulët pas tij. Rrjedhimisht as ky OE nuk ka përmbushur kërkesat si më sipër të DT. Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar.

**Lidhur me pretendimin ankimor nr. 5** - është gjetur se operatori ekonomik "Anesi" Sh.P.K. i cili ka tenderuar për lot 2, 3 dhe 4, nuk ka dorëzuar fare deklaratat tatimore në ATK për tri vitet e fundit. Në vend të kësaj OE ka dorëzuar një vërtetim nga banka NLB ku thuhet se nga data 01.01.2021 deri me datë 03.04.2024 ka qarkullim prej 902,668.83 euro. Mirëpo kërkesa e DT ka qenë specifike dhe aty thuhet se kërkohet qarkullimi në tri vitet e fundit që nënkupton vetëm për vitin fiskal 2021, 2022 dhe 2023 por jo edhe për vitin 2024 sepse ky vit fiskal ende nuk ka përfunduar. Prandaj pretendimi është i bazuar.

**Lidhur me pretendimin ankimor nr. 6** - është gjetur se ky GOE ka dorëzuar referencat sipas listës së kontratave dhe në përputhje me dosjen e tenderit. Prandaj ky pretendim është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 02.07.2024**

**Visar SHEHU**  
  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.